



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALISE - IZLAZNA

№/Br 01/1517
MB/Dana 10.07.2023.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI I KOMUNËS – SKUPŠTINA OPŠTINE-MUNICIPAL ASSEMBLY

Në bazë të nenit 12 dhe 17 nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008), nenit 5 nënparagrafi 1.2 nënparagrafi 1.2.2, nenet 10,Paragrafi 2,nënparagrafi 2.1,neni 11,16 dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 i datës:23.08.2013 (Gazeta Zyrtare nr.30 të datës:23.08.2013), si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunes, si dhe nenit 10 shkronja b të Statutit të Komunës së Novobërdës Nr.01-992 të datës 02.10.2012 , Kuvendi Komunal i Komunës së Novobërdës me datë: **29.06.2023**, merrë këtë:

VENDIM

Për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunes së Novobërdës

Neni 1

Lloji i dokumentit të Planifikimit Hapësinor

Me këtë vendim fillohet Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Novobërdës

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të Planifikimit Hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor. Harta Zonale e Komunës së Novobërdës në harmoni me ligjin përkufizohet si dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve ,fotografive,hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin,destinimin,shfrydizimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tër territorin e komunes,për perjudhen (8)vjeqare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Harten Zonale të Komunës nga neni 1 i vendimi,përcaktohen kushtet zhvillimore dhe ndertimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritue kushte optimale të rregullimit të ndertimit në komunën e Novobërdës,plotson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonat urbane dhe rurale. Hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Novobërdës, plotëson kërkesat ligjore për të pregaditur planin strategjik multi – sektorial i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4

Kufiri i territorit

Zona kadastrale në territorin e Komunës së Novobërdës përfshijnë 24 zona ato janë:

Zona Kadastrale		Kodi I Zones Kadastrale	Nr.i Parcelave ne Z.Kadastrale	Siperfaqja e Z.Kadastrale në m ²	Siperfaqja në Ha
1	Bostan	72403002	2123	89.746.80	
2	Kufcë	72403014	5006	159.299.37	
3	Makresh I Epërm	72403017	1834	93.842.93	
4	Makreshi I Ultë	72403021	1029	50.845.10	
5	Dragancë	72403022	668	45.151.75	
6	Zebincë	72403027	2595	85.822.59	
7	Izvor	72403028	3918	157.786.69	
8	Jasenovik	72403030	2555	96.923.32	
9	Kllobukar	72403031	1950	92.465.03	
10	Koretishtë	72403034	4973	184.453.14	
11	Manishincë	72403040	941	27.951.06	
12	Mozgovë	72403042	1023	15.158.41	
13	Novobërdë	72403044	683	56.007.99	
14	Parallovë	72403046	4995	172.985.04	
15	Prekoc	72403053	3083	81.205.82	
16	Stanishor	72403056	1294	63.442.98	
17	Strazhë	72403058	4201	158.407.57	
18	Tërniquec	72403060	1036	28.779.96	
19	Bolec	72407006	2085	66.637.77	
20	Bushincë	72407010	3907	82.642.74	
21	Miganoc	72407053	2265	53.658.70	
22	Tirincë	72407072	1912	44.247.89	
23	Llabjan	72414040	1885	95.598.66	
24	Carefc	72407078	1251	36.552.92	

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i Hartimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet është Drejtorja për Urbanizem

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Drejtorja e Urbanizmit koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunes me drejtorit sektoriale dhe burimet njerzore brenda komunës, në bazë të kontratës të lidhur me kontraktorin e përzgjedhur përmes procedurave të prekurimit publik sipas ligjit.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor, sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që Hartën Zonale të Komunës ta hartojë në afat prej tetëdhjetë (18) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 8

Konsultimet Publike

Projekti i Hartës Zonale të Komunës para finalizimit duhet të vihet në diskutim publik dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e projekt të Hartës Zonale të Komunës së Novobërdës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komentëve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore 8 (Tetë) vjeqare.

Neni 10

Gjuha Zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor duhet të jetë në gjuhë zyrtare të komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjesë e këtij Vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit të paraparë me nenin 11 pika 1.3. të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga kuvendi i komunes dhe vlersimit të ligjëshmërisë nga MAPL-ja-15 ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokolit të ministrit përgjegjës për vetqeverisje lokale si dhe publikimi në web faqen zyrtare të komunes.

Në: Novobërdë

Më:10.07.2023

Mirjana Simijonović

Kryesuese e Kuvendit

